

Jovanka Joleska Popovska

Ka lindur në Shkup, më 24 Korrik 1972. Ajo u diplomua si ekonomiste në Fakultetin Ekonomik - Ss. Cyril and Methodius University, në Shkup. Ajo ka marrë pjesë në disa trajnime profesionale të organizuara nga KMGP dhe ka përfunduar gjithashtu edhe Akademinë ProCredit në Gjermani.

Znj. Popovska e filloi karrierën e saj në KMGP në Maqedoninë e Veriut, duke punuar në disa pozicione, si Asistent Auditues, Auditues i lartë, Asistent Menaxher dhe Menaxher i Auditimit.

Ajo u bashkua ProCredit Bank në Maqedoninë e Veriut në vitin 2003 si Drejtuese e Departamentit të Kontrollit të Brendshëm. Në këtë pozicion, ajo ishte përgjegjëse për kryerjen e të gjitha aktiviteteve në përputhje me parimet dhe standardet e auditimit të brendshëm, kodit të etikës së Bankës si dhe politikat dhe procedurat e departamentit. Nga Nëntor 2004 deri në Shkurt 2009 ajo u bë zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i ProCredit Bank Maqedoni e Veriut, duke qenë përgjegjëse për Divizionin e Financave, Shërbimit të Brendshëm dhe Menaxhimit të Riskut.

Që nga Shkurti 2009 deri në Prill 2021 ajo ka shërbyer si Drejtuese e Përgjithshme e ProCredit Bank Maqedoni. Aktualisht është anëtare e Këshillit Drejtues të ProCredit Holding (që nga Maj 2021) dhe anëtare e Këshillit Drejtues të ProCredit Bank Maqedoni e Veriut (që nga Korrik 2021).